



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-030101-24934/18 më 30. 01. 2018

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/04, qershor 2008), të nenit 24, pikat 5 dhe 6 të Ligjit nr. 03/L-160, për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, dhe të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me qëllim të uljes se nivelit te ndotjes se ajrit, merr këtë

V E N D I M

- I. **N D A L O H E T** shitja e thëngjillit brenda territorit të komunës së Prishtinës.
- II. **N D A L O H E T** qarkullimi i të gjitha automjeteve brenda qytetit të Prishtinës, nga ora 06:00 - 22:00, përveç:
1. Automjeteve të transportit publik;
 2. Automjeteve emergjente;
 3. Automjeteve të Policisë së Kosovës;
 4. Automjeteve të misioneve diplomatike;
 5. Automjeteve të FSK-së;
 6. Automjeteve të KFOR-it;
 7. Automjeteve të EULEX-it;
 8. Automjeteve të Drejtorisë së Inspeksionit;
 9. Automjeteve - taksi të licencuara
 10. Automjeteve për bartjen e personave me aftësi të veçanta të cilat mbajnë shenje identifikuese.
- III. Zona e ndaluar përfshinë këto rrugë:
1. Bulevardi "Bill Klinton" nga udhëkryqi i rrugëve "Idriz Gjilani" dhe "Bekim Fehmiu", gjegjësisht nga shtatorja "Bill Klintoni";
 2. Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nga rrethrotullimi i flamurit;
 3. Rruga "Agim Ramadani" nga udhëkryqi i konvikteve;
 4. Rruga "Edmond Hoxha" te salla "1 Tetori";
 5. Rruga "Ilir Konushevc", nga hyrja e drejtimit të Podujevës;
 6. Hyrja nga rrethrotullimi i lagjes "Arbëria" në rrugët "UÇK" dhe "Fehmi Agani".

- IV. Transporti i udhëtarëve nga NPL "Trafiku Urban" në intervalin kohor të cekur në pikën I, do të bëhet pa pagesë, financiar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
- V. Furnizimi i bizneseve me mallra duhet të kryhet në intervalin kohor prej orës 22:00 - 06:00.
- VI. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Inspeksionit.
- VII. Policia e Kosovës do të asistojë në zbatimin e pikës II të këtij vendimi.
- VIII. Ky vendim fillon të zbatohet nga data 31.01.2018 deri në marrjen e një vendimi tjetër nga Komuna e Prishtinës.
- IX. Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftojë qytetarët dhe subjektet tjera për këtë vendim, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.
- X. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Drejtorisë së Inspeksionit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNES
Shpend Ahmeti

